

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikalastic®-612

MEMBRANË E LËNGSHME POLIURETANI ME 1 PËRBËRËS DHE KOSTO EFIKASE PËR HIDROIZOLIM



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikalastic®-612 është membranë hidroizoluese poliuretani me 1 përbërës që aplikohet me metodën e ftohtë dhe aktivizohet me lagështinë. Kur thahet formon një membranë pa bashkime dhe rezistente për hidroizolim të tarracave/çatave dhe strukturave të ekspozuara, si dhe gjithashtu poshtë pllakave në ballkone dhe tarraca.

PËRDORIMET

- Për hidroizolim çatish/tarracash në ndërtime të reja dhe projekte rikonstruksioni
- Për çati/tarraca me zona të ndërlikuara detajesh, edhe kur aksesimi është i kufizuar
- Për zgjatje me kosto efikase të ciklit të jetës së çatave/tarraceve të dëmtuara
- Për hidroizolim nën pllakat e ngjitura me kollë në ballkone dhe tarraca

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës - pa përzjerje, përdorim i lehtë dhe i shpejtë
- Aplikim me metodë të ftohtë - nuk kërkohet nxehtësi apo zjarr
- Membranë pa bashkime
- Mund të përforcohet ku kërkohet
- Mund të rivishet me lehtësi kur nevojitet - nuk kërkohet heqja e veshjes ekzistuese

- Ekonomik - ofron zgjatje efikase të ciklit të jetës të çatave/tarracave të dëmtuara
- I përshkueshëm nga avulli - lejon transpirimin e nënshtresës
- Elastik - ruan fleksibilitetin edhe në temperatura të ulëta
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e nënshtresave - shih tabelën
- Tharje e shpejtë - pa dëmtim nga shiu pothuajse menjëherë pas aplikimit

MIRATIME / STANDARDE

- Material i lëngshëm për hidroizolim tarrace sipas ETAG 005, ETA-12/01278 lëshuar nga organi i vlerësimit teknik British Board of Agrément, Deklaratë Performance 80192223 dhe mbart markën CE
- Produkt i lëngshëm dhe i papërshkueshëm nga uji për instalime të jashtme nën pllakat qeramike sipas DIN EN 14891:2012-07, Deklaratë Performance 28643599, vlerësuar nga laborator i njoftuar 0761 dhe mbart markën CE.
- Performancë ndaj zjarrit të jashtëm sipas ENV 1187: Broof (t1)
- Reagimi ndaj zjarrit sipas EN13501-1 : Euroclass E

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan aromatik 1 përbërësi që aktivizohet me lagështinë
Ambalazhi	kova metalike 5 l (~7.1 kg) dhe 15 l (~21.3 kg)
Ngjyra	e bardhë (RAL 9010), gri (RAL 7032), terracotta, ngjyra të tjera me porosi
Jetëgjatësia	9 muaj nga data e prodhimit

Kushtet e magazinimit

Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis 0°C dhe +25°C.
Temperatura më të larta magazinimi mund të reduktojnë jetëgjatësinë e produktit.
Referohuni tek rekomandimet për magazinimin në fletën e të dhënave të sigurisë.

Dendësia ~1.42 kg/l (23 °C) (EN ISO 2811-1)

Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë ~80 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)

Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim ~68 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	E papërforcuar	E përforcuar	(EN ISO 527-3)
	~4.5 N/mm ²	~8 N/mm ²	

Zgjatimi deri në thyerje	E papërforcuar	E përforcuar	(EN ISO 527-3)
	~180 %	~50 %	

Temperatura e funksionimit -20 °C min. / +80 °C max.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Veshje për tarracat/çatitë*

Sikalastic®-612 aplikohet në 1 ose 2 veshje

Konsumimi total $\geq 0.7 - 2.0 \text{ l/m}^2 (\geq 1.0 - 2.8 \text{ kg/m}^2)$

Trashësia e veshjës së thatë $\geq 0.7 - 1.4 \text{ mm}$

*Për përforcim të pjesshëm aplikohet Sikalastic® Fleece-120 ose Sikalastic® Flexitape Heavy në zona me lëvizshmëri të lartë, nënshtrësë të çrregullt, plasaritje, fuga dhe tegela si dhe gjithashtu në detaje. Mbi membranën bituminoze duhet aplikuar një sistem hidroizolimi plotësisht i përfortuar.

Për prajmerin, ju lutemi referohuni në tabelën e mëposhtme të trajtimit paraprak.

Hidroizolim tarrace/çatie me përforcim

Sikalastic®-612 aplikohet në një veshje të përfortuar me Sikalastic® Fleece-120 dhe izoluar me veshje shtesë Sikalastic®-612

Shtresa	Produkti	Konsumimi
1. Prajmer	ju lutemi referohuni në trajtimin paraprak të nënshtrësës	ju lutemi lexoni skedën teknike të prajmerit
2. Veshja filestare	Sikalastic®-612	$\geq 1.0 \text{ l/m}^2$ ($\geq 1.4 \text{ kg/m}^2$)
3. Përforcimi	Sikalastic® Fleece-120	-
4. Veshja përfundimtare	Sikalastic®-612	$\geq 1.0 \text{ l/m}^2$ ($\geq 1.4 \text{ kg/m}^2$)

Hidroizolim nën pllaka të ngjitura me kollë*

Sikalastic®-612 aplikohet mbi beton ose llaç në 2 veshje, që ndiqen nga një veshje tjetër me Sikalastic®-612 të spërkatur me rërë kuarci.

Shtresa	Produkti	Konsumimi
1. Prajmer	Sika® Concrete Primer ose Sika® BondingPrimer	ju lutemi lexoni skedën teknike të prajmerit
2. Veshja fillestare	Sikalastic®-612	$\geq 1.0 \text{ l/m}^2$ ($\geq 1.4 \text{ kg/m}^2$)
4. Veshja përfundimtare	Sikalastic®-612	$\geq 1.0 \text{ l/m}^2$ ($\geq 1.4 \text{ kg/m}^2$)
5. Ndërkapja	Sikalastic®-612 i spërkatur me 2 kg/m^2 rërë kuarci ($\varnothing 0.4 - 0.7 \text{ mm}$)**	$\geq 0.2 \text{ l/m}^2$ ($\geq 0.2 \text{ kg/m}^2$)
6. Kollë pllakash	SikaCeram®-205 Xtra Large	ju lutemi lexoni skedën teknike të kollës së pllakës

*Për përforcim të pjesshëm aplikohet Sikalastic® Fleece-120 ose Sikalastic® Flexitape Heavy në zona me lëvizshmëri të lartë, nënshtrësë të çrregullt, plasaritje, fuga dhe tegela si dhe gjithashtu në detaje.

**Rëra e tepërt duhet të hiqet pas tharjes së membranës së lëngshme.

Shënim: Këto vlera janë teorike dhe nuk përfshijnë asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firos.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit $+5 \text{ °C min.} / +40 \text{ °C max.}$

Lagështia relative e ajrit $5 \text{ % min.} / 85 \text{ % max.}$

Temperatura e nënshtrësës $+5 \text{ °C min.} / +60 \text{ °C max.}$
Min. 3 °C mbi pikën e vesës

Lagështia e përmbajtur e nënshtrësës $\leq 4 \text{ %}$ pjesë për peshë përmbajtje lagështie.
Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex
Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietileni).

Përgatitja e nënshtresës

Nënshtresa	Prajmer
Nënshtresa çimentoje	Sika® Concrete Primer Sika® Bonding Primer
Tulla dhe gur	Sika® Concrete Primer Sika® Bonding Primer
Pllaka qeramike (pa glazurë), dhe pllaka betoni	Sika® Concrete Primer Sika® Bonding Primer
Membrana & veshje bituminoze	Sikalastic® Metal Primer
Metale	Sikalastic®-Metal Primer
Metale ferroze ose të galvanizuara, plumb, bakër, alumin, tunxh ose çelik i galvanizuar	
Nënshtresa druri	Tarracat prej druri kërkojnë një shtresë të plotë Sikalastic® Carrier. Për pjesë të vogla të ekspozuara përdorni Sika® Concrete Primer ose Sika Bonding Primer.
Bojëra	Subjekt i testimeve të ndërkapjes dhe kompatibilitetit
Sistemi ekzistues SikaRoof® MTC	Sika® Reactivation Primer

Për konsumimin dhe kohën e pritjes / mbiveshjen ju lutemi referohuni në skedën teknike të pastruesit dhe prajmerit të duhur. Nënshtresat e tjera duhet të testohen për kompatibilitetin e tyre. Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

Koha e punueshmërisë

Sikalastic®-612 është krijuar për tharje të shpejtë. Temperaturat e larta në kombinim me lagështinë e lartë të ajrit do të përshejtojnë tharjen. Kështu, materiali në enë të hapur duhet të aplikohet menjëherë. Në enën e hapur, materiali do të formojë një cipë pas ~ 1 ore (+20 °C / 50 % lagështi relative)

Koha e pritjes / mbiveshja

Kushtet e ambientit	Koha min. e pritjes*
+5 °C / 50 % lagështi relative	18 orë
+10 °C / 50 % lagështi relative	12 orë
+20 °C / 50 % lagështi relative	6 orë
+30 °C / 50 % lagështi relative	4 orë

*Pas 4 ditësh sipërfaqja duhet të pastrohet dhe të lyhet me prajmerin Sika® Reactivation Primer përpara vazhdimin.

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Kushtet e ambientit	Rezistencë ndaj shiut*	I thatë në prekje	Tharja e plotë
+5 °C / 50 % lagështi relative	10 minuta	8 orë	18 orë
+10 °C / 50 % lagështi relative	10 minuta	6 orë	10 orë
+20 °C / 50 % lagështi relative	10 minuta	4 orë	7 orë
+30 °C / 50 % lagështi relative	10 minuta	2 orë	5 orë

*Kujdes: Ndikimi i shiut të rëndë mund të dëmtojë fizikisht membranën ende të lëngshme.

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme, e pastër, e thatë, pa vaj, graso dhe kontaminues të tjerë. Në varësi të materialit nënshtresa duhet lyer me prajmer ose të përgatitet mekanikisht. Mund të nevojitet bluarje e sipërfaqes për nivelim. Nënshtresa të përshtatshme janë: betoni,

letrat e katramasë, metali, tullat, çimento asbesti, pllaka qeramike, nënshtresa druri.

Për informacione të detajuara rreth përgatitjes së nënshtresës & tabelës së prajmerave ju lutemi referohuni tek Method Statement No. 850 915 08.

PËRZIERJA

Nuk kërkohet përzierje, megjithatë nëse produkti është ndarë gjatë hapjes, përzieni ngadalë, por plotësisht Sikalastic®-612 për të arritur një ngjyrë të njëtrajtshme. Përzierja e ngadaltë do të pakësojë bllokimin e ajrit.

APLIKIMI

Përpara aplikimit të Sikalastic®-612, prajmeri (nëse do të përdoret) duhet të jetë tharë. Për kohën e pritjes / mbiveshjen ju lutemi referohuni në skedën teknike të prajmerit të duhur. Zonat e dëmtueshme (parmakë etj.) duhet të mbrohen me shirit ose mbështjellje plastike.

Veshje për çati/tarraca:

Sikalastic®-612 aplikohet në dy veshje. Përpara aplikimit të veshjes së 2-të duhet të lini kohën e treguar në tabelën me kohët e pritjes / mbiveshjes. Veshjet e çative/tarracave mund të kenë nevojë për përforsim të pjesshëm mbi zona me sforcim ose lëvizje të parashikuar p.sh. fugat, mbivendosjet, detajet, etj. Përdorni shirita ose pjesë Sikalastic® Fleece-120 për sipërfaqe të qëndrueshme - çimento asbesti etj. Për fuga me lëvizje të moderuar p.sh. në fleta metalike përdorni Sika® Flexitape Heavy duke inkorporuar ndërprerje të ngjitjes.

Hidroizolim tarracash/çatish me përforsim:

Sikalastic®-612 aplikohet në kombinim me Sikalastic® Fleece 120. Mbiveshja e letrës së katramasë duhet të jetë plotësisht e përforsuar.

1. Aplikoni shtresën e parë me ~ 1.3 l/m² Sikalastic®-612. Punoni materialin për aq kohë sa është i lëngshëm.
2. Aplikoni Sikalastic® Fleece-120 dhe sigurohuni se nuk ka flluska apo rrudhosje. Mbipalosni përforsimin në gjerësi min. 5 cm dhe sigurohuni se mbivendosjet janë mjaftueshëm të lagura për t'u ngjitur.
3. Ruli mund të ketë nevojë vetëm për pak material shtesë për t'a mbajtur të lagur, por nuk duhet të shtoni material në këtë fazë.
4. Pasi veshja të jetë tharë mjaftueshëm për të ecur përsipër, izoloni zonën e tarracës/çatisë me një veshje të dytë Sikalastic®-612 me min. 0.7 l/m² për veshje.

Ju lutemi, filloni gjithmonë me detajet përpara se të filloni me hidroizolim të sipërfaqes horizontale. Për detajet ndiqni hapat 1-4.

Hidroizolim poshtë pllakave:

Për hidroizolim poshtë pllakave, ndiqni udhëzimet për veshjet e çative/tarracave. Pasi të jetë tharë veshja e fundit e sistemit të hidroizolimit, aplikoni një veshje tjetër Sikalastic®-612 të spërkatur me rërë kuarci (Ø 0.4 - 0.7 mm) për ndërkapje. Hiqni rërën e tepërt pasi të jetë tharë membrana e lëngshme. Për aplikimin e kollës së pllakës, ju lutemi lexoni skedën teknike të produktit të kollës së pllakave.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikalastic®-612 mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Sikalastic®-612 nuk është i përshtatshëm për zhytje të përhershme në ujë.
- Mbi nënshtresa që mund të paraqesin degazim (outgassing), aplikoni gjatë temperaturave në rënie të mjedisit dhe nënshtresës. Nëse aplikohet gjatë temperaturave në rritje mund të shkaktohen vrima të vogla (sa maja e gjilpërës) nga avujt në rritje.
- Mos holloni Sikalastic®-612 me asnjë tretës.
- Mos përdorni Sikalastic®-612 për aplikime në mjedis të brendshme.
- Mos e aplikoni pranë tubacionit të ajrit të njërive të kondicionerëve që punojnë.
- Mos aplikoni Sikalastic®-612 direkt mbi pllakat termoizoluese Sikalastic®. Në vend të këtyre përdorni Sikalastic® Carrier ndërmjet pllakës termoizoluese Sikalastic® dhe Sikalastic®-612.
- Materialet bituminoze fluorore mund të njollosin dhe/ose të zbuten poshtë veshjes.
- Zonat me lëvizshmëri të lartë, nënshtresat e çrregullta apo çatitë/tarracat prej druri kërkojnë një shtresë të plotë Sikalastic® Carrier.
- Sikalastic®-612 mund të paraqesë kalcifikim të lehtë mbi sipërfaqe - mos përdroni ujin e mbledhur nga tarracat për akuariume, etj.
- Materialet bituminoze me pikë shkrirjeje të ulët mund të kenë nevojë për prajmer - përdorimi i një ngjyrë më të errët, mund të ndihmojë në fshehjen e njollave nga fluororët.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikalastic®-612
Shkurt 2019, Botimi 03.01
020915205000000014

Sikalastic-612-sq-AL-(02-2019)-3-1.pdf

